



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 20.01.2014
Nr.0204-80

PËR: Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës
Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës

LËNDA: KONFIRMIMI I LIGJSHMERISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË Podujevës Nr. 01-006-4624, të pranuar më datën 20.01.2014

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në nenin 76.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas shqyrtimit të vendimit Nr. 01-013/55 të miratuar me datën 15.01.2014 nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, KONFIRMON ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik është si në vijim:

- Vendimi me Nr. 01-006-4624, për dhënien në përdorim të lloptopëve anëtarëve të kuvendit të Komunës së Podujevës.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana: 20.01.2014
Br. 0204-80

Za : Agim Veliu, Gradonačelnik Opštine Podujevo
Mehmet Gashi, Predsedavajući Skupštine Opštine Podujevo

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE SKUPŠTINE OPŠTINE VITINA, Br. 01-006//4624, primljena dana 20.01.2014

Poštovani,

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu br. 03/L-040 za Lokalnu samoupravu, Zakonu br. 03/L-025 o Zaštiti Sredine, dodatku XII Uredbe Vlade, Br. 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke Br. 01-013/55 usvojene dana 15.01.2014 od Skupštine Opštine Podujevo , **POTVRDJUJE zakonitost** akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravni Akti koji proizvodi puni pravni efekat.

- Odluka br.01-012-4619, o davanju na korišćenje laptopa članovima Skupštine Opštine Podujevo.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera & Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivu MALS-a



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujevo

KUVENDI

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d dhe 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenit 2.1 të Rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore të Ministrisë së Financave dhe nenit 17.1 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-1/298-10, të datës 12 tetor 2009, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 15 janar 2014, miratoi këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË LLAPTOPËVE KËSHILLTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

Këshilltarëve të Kuvendit, me qëllim të ushtrimit të funksionit të tyre në mënyrë sa më efektive, avancimit të punës së Kuvendit në përgjithësi dhe dërgimit të thirrjeve dhe materialeve të mbledhjeve në mënyrë elektronike, u jepen në përdorim nga një laptop.

Neni 2

Këshilltarët e Kuvendit janë të obliguar t'i ruajnë e mirëmbajnë laptopët dhe t'i përdorin vetëm për punët dhe aktivitetet në kuadër të fushëveprimtarisë së Kuvendit dhe trupave punuese të Kuvendit si dhe për komunikim zyrtar.

Neni 3

Shërbimi dhe mirëmbajtja teknike e laptopëve bëhet në zyrën e Teknologjisë Informatike të Komunës.

Neni 4

Këshilltari mbanë përgjegjësi për dëmtime fizike, humbje apo tjetërsim të laptopit.

Neni 5

Laptopët janë aset i Komunës, të njëjtit kthehen me rastin ndërprerjes eventuale të mandatit të këshilltarit përkatësisht me përfundimin e mandatit të Kuvendit.

Neni 6

Zbatimin e vendimit e bëjnë Zyra e Teknologjisë Informatike dhe Zyrtari i pranimit – depoisti.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas vlerësimit të ligjshmërisë, përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-006-4624

Podujevë,
15 janar 2014



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi